



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

07 Nr. 320-5625/22

Klinë, me 23.02.2022

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e kulturave të perimtarisë ( furnizim me sera m<sup>2</sup> ).

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë- kulturës se perimtarisë, Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, bën :

## THIRRJE PUBLIKE

Fton fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e ngritjes se serave në sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup>.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuoj :

- Me 70 % të kostos se seres, ndërsa fermeri me 30 %; dhe
- Dhënien e këshillave profesionale, përmes eksperteve të saj.

### Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës se Klinës;
2. Të posedoj sipërfaqe të mjaftueshme të tokës për vendosjen e serës. Toka duhet të jetë në emër të aplikuesit apo ndonjërit nga familjaret e ngushtë apo të këtë kontratë të vërtetuar nga noteri për shfrytëzimin e saj;
3. Të këtë mundësi ujitje (posedon bunar);
4. Të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të mjeteve financiare në koston e serës;
5. Përparësi do të kenë fermerët nga zonat rural dhe ata të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë nga projektet e komunës - DBPZHR.

## **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

1. Kërkesa e plotësuar nga fermeri, e cila merret në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës;
2. Fleta poseduese;
3. Kopja e certifikatës së NIF-it;
4. Certifikata e vendbanimit;
5. Kopja e letërnjoftimi;
6. Vërtetimi i tatimit në pronë.

Afati i aplikimit, është nga data **24.02.2020**, deri me dt. **07.03.2022**. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën pritëse në hyrje të objektit të komunës.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

**Vërejtje:** Nëse të dhënat e deklaruara në kërkesën për aplikim nuk përputhen, me gjendjen faktike të vërtetuar në teren nga komisioni, aplikuesi do të sanksionohet me minues 10 pikë.

Drejtori / Drejtorisë së BPZH  
Lorenc Marleku

